

Përmbledhje

Ekonomia e eurozonës, sipas të dhënave preliminare të Eurostatit, është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik në TM3 2019 (1.2 përqind), gjë që ka ndikuar në një rritje të ngadalësuar edhe të inflacionit (0.9 përqind). Ngjashëm me eurozonën edhe aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar me rritje të ngadalësuar (3.1 përqind në TM2 2019).

Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në gjysmën e parë të vitit 2019 shënoj rritje vjetore prej 4.2 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe përmirësimeve në eksportet neto. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM3 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike gjatë këtij tremujori vlerësohet të jetë e ngjashme me tremujorët paraprak të vitit 2019. Këto vlerësime mbështeten në zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm (rritjes së përshpejtuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve, IHD-ve) si dhe rritjes së kredive të reja.

Niveli i çmimeve të konsumit deri në shtator 2019 është rritur për 3.0 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), shënoi rritje prej vetëm 0.4 përqind apo 2.6 pikë përqindje më ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.

Sektori fiskal deri në shtator 2019 u karakterizua me rritje të të hyrave prej 6.9 përqind dhe ngadalësim të rritjes së shpenzimeve buxhetore prej 3.8 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 39.1 milionë euro (0.8 milionë euro deficit në periudhën e njëjtë të vitit 2018). Borxhi publik në TM3 2019 ka arritur në 1.19 miliardë euro, që është për 10.7 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.4 përqind nga 16.9 përqind sa ishte në TM3 2018.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019, asetet e sektorit financiar u zgjeruan për 340.0 milionë euro, kryesisht si rezultat i zgjerimit të aktivitetit të sektorit bankar dhe atij pensional, si dy sektorët me kontributin më të madh në sistemin financiar në vend. Për më shumë, sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të aktivitetit ndërsa ai i sigurimeve me përmirësim të aktivitetit.

Deri në gusht 2019, sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 60.7 përqind. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ndërsa deficitit i mallrave shënoj rritje të ngadalësuar. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rritje vjetore prej 6.3 përqind përkatësisht 22.9 përqind.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	4
Ekonomia e Kosovës -----	6
Sektori Real -----	6
Çmimet -----	6
Sektori Fiskal -----	7
Sektori Financiar -----	8
Sektori i Jashtëm -----	9

FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në Eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni I përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	06
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj-----	09
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 8. Remitencat-----	11
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve-----	11
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale-----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	07

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IÇI	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistikore të Bashkimit Evropian (Eurostat), në TM3 2019 ekonomia e eurozonës shënoj rritje vjetore prej 1.2 përqind, që është një normë e rritjes më e ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 2.6 përqind në TM3 2018 (figura 1).



Ky ngadalësim i aktivitetit ekonomik pasqyron dobësitë e vazhdueshme të tregtisë globale e cila është duke u karakterizuar me rritje të proteksionizmit, mundësia e një Brexiti pa marrëveshje, zvogëlimi i prodhimit të makinave, etj. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik, veçanërisht në sektorët e ekspozuar ndaj tregtisë globale, ka ndikuar besueshmërinë e bizneseve dhe për rrjedhojë pritjet për ecurinë e aktivitetit ekonomik në periudhat në vazhdim nuk janë edhe aq optimiste. Projektionet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) sugjerojnë për një rritje të ngadalësuar

ekonomike në tre vitet e ardhshme (1.1 përqind në 2019, 1.2 përqind në 2020 dhe 1.4 përqind në 2021).

Në linjë me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik, edhe shkalla e inflacionit ishte më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në eurozonë në TM3 2019 ishte 0.9 përqind (2.1 përqind në TM3 2018) (figura 1). Si rezultat i nivelit të ulët të inflacionit, në shtator 2019, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.50 përqind).

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 2.9 përqind ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.2 përqind. Në anën tjetër, depozitat në sistemin bankar janë rritur akoma më shumë dhe kanë shënuar normën e rritjes prej 5.6 përqind për ndërmarrjet dhe 5.5 përqind për ekonomitë familjare.

Edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, aktiviteti ekonomik në TM2 2019¹ ka shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej mesatarisht 3.1 përqind (4.3 përqind në TM2 2018). Pothuajse të gjitha shtet shënuan ngadalësim të rritjes krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 (tabela 1).

¹ Të dhënat për TM2 2019 nuk janë publikuar ende, ndërsa për Bosnje e Hercegovinën nuk janë publikuar që nga TM2 2018.

Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2
Kosova	2.9	4.4	3.7	4.1	4.2	4.1
Mali i Zi	4.5	4.9	5.0	4.8	3.0	3.2
Maqedonia e Veriut	0.9	3.0	3.0	3.7	4.1	3.1
Serbia	4.9	4.9	4.1	3.4	2.7	2.9
Shqipëria	4.3	4.3	4.7	3.3	2.4	2.3

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Në TM3 2019 norma mesatare e inflacionit prej 1.0 përqind ishte më e ulët krahasuar me normën e inflacionit prej 1.9 përqind në TM3 2018. Normat më të ulëta të inflacionit ishin evidente kryesisht në Mal të Zi, Bosnje e Hercegovinë dhe Maqedoni të Veriut, ndërsa në Kosovë, Shqipëri dhe Serbi normat e inflacionit ishin më të larta (tabela 2).

Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3
Bosnja dhe Hercego	0.8	1.4	1.8	1.7	1.0	0.6	0.4
Kosova	0.0	0.7	1.4	2.2	3.2	3.3	2.6
Mali i Zi	3.7	3.7	2.4	1.7	0.4	0.5	-0.1
Maqedonia e Veriut	1.5	1.5	1.6	1.2	1.2	1.2	0.6
Serbia	1.6	1.8	2.4	2.0	2.4	2.3	1.3
Shqipëria	1.9	2.2	2.2	1.8	1.6	1.4	1.4

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, rritja e kredive dhe depozitave ishte e konsiderueshme dhe me diferenca të theksuara ndërmjet vendeve. Në TM3 2019, norma mesatare e rritjes së kredive ishte 6.5 përqind (6.1 përqind në TM3 2018). Vendet të cilat shënuan rritje më të lartë kreditimit ishin Kosova dhe Serbia (10.4 përqind përkatësisht 9.7 përqind). Depozitat shënuan normë edhe më të lartë të rritjes krahasuar me kreditë. Në TM3 2019, norma mesatare e rritjes së depozitave ishte 8.3 përqind në nivel të rajonit. Tek depozitat, sikurse tek kreditë, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Kosovë dhe Serbia (13.7 përqind përkatësisht 13.7 përqind), pasuar nga Bosnja e Hercegovina me 9.5 përqind, Maqedonia e Veriut me 8.8 përqind, etj.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, euro është vlerësuar ndaj lirës turke për 25.6 përqind ndërsa është zhvlerësuar ndaj valutave tjera kryesore por edhe ndaj valutave të vendeve të rajonit. Ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 6.7 përqind, ndaj lekut shqiptar 4.7 përqind, ndaj frankës zvicerane për 3.4 përqind dhe dinarit serb për 0.2 përqind.


Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Sipas të dhënave tremujore të ASK-së, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje mesatare prej 4.2 përqind në gjysmën e parë të vitit 2019 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 kur ishte shënuar rritje prej 3.7 përqind. Kontributin më të madh në rritjen e BPV-së e kishin ndërtimtaria e cila shënoj rritje për 8.8 përqind, industria përpunuese (7.4 përqind rritje) dhe tregtia (6.1 përqindje rritje).

Sipas qasjes së shpenzimeve, investimet shënuan kontributin kryesor në rritjen ekonomike me 2.3 pikë përqindje pasuar nga konsumi me 1.2 pikë përqindje dhe eksportet neto me 0.7 pikë përqindje (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK (2019) dhe llogaritjet e BQK -së

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, kreditë e reja konsumuese kanë shënuar rënie prej 9.8 përqind duke ndikuar kështu në ngadalësimin e rritjes së konsumit. Përveç rënies së kredive konsumuese edhe burimet tjera të financimit të konsumit si remitencat, kompensimi i punëtorëve dhe shpenzimet për paga në sektorin publik u karakterizuan me ngadalësim të rritjes. Në të njëjtën periudhë, IHD-të të cilat shënuan


rritje prej 19.3 përqind ndikuan në rritjen e investimeve. Në anën tjetër, ngadalësimi i rritjes së kërkesës së brendshme ka ndikuar në ngadalësimin e rritjes së importit ndërkohë që eksporti ka shënuar rritje të përshpejtuar. Kjo ka bërë që eksportet neto të shënojnë deficit më të ulët tregtarë prej rreth 1.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018.

Meqenëse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në e TM3 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, BQK vlerëson se rritja ekonomike gjatë këtij tremujori pritet të jetë e ngjashme me tremujorët paraprak të vitit 2019. Pritjet e BQK-së për këtë nivel të rritjes ekonomike kryesisht mbështeten në zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm (rritjes së përshpejtuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve, IHD-ve) si dhe rritjes së kredive të reja por edhe konsumit dhe investimeve publike. Në anë tjetër, importi i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje më të lartë gjatë TM3 2019 krahasuar me tremujorin paraprak.

Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit u rrit ndjeshëm që nga tremujori i fundit i vitit 2018 dhe është duke vazhduar këtë trend të rritjes edhe në vitin 2019 (figura 3).

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2019)

Deri në shtator 2019 norma mesatare e rritjes së çmimeve të konsumit ishte 3.0 përqind (0.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2018). Kjo rritje e çmimeve ishte më e theksuar tek çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, të cilat kontribuuan me 2.42 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm, pasuar nga çmimet e transportit me 0.19 pikë përqindje si dhe çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit me 0.18 pikë përqindje (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin

Përshkrimi	Peshat 2019	Norma e inflacionit	Kontributi
<i>Gjithsej</i>	100.0%	3.0	3.00
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.0%	6.1	2.42
Pijet alkoolike dhe duhani	5.6%	2.8	0.18
Veshmbathja	3.9%	0.4	0.02
Energjia	7.7%	0.3	0.02
Orenditë	7.9%	1.0	0.08
Shëndetësia	2.5%	0.4	0.01
Transporti	15.4%	1.2	0.19
Komunikimi	3.7%	0.0	0.00
Rekreacioni	4.4%	0.4	0.02
Arsimi	1.0%	-0.9	-0.01
Hoteleria	3.1%	1.5	0.05
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.9%	1.2	0.06

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Siç shihet në tabelë, shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan) dhe përjashtimi i këtyre komponentëve bënë që inflacioni bazë të jetë më stabil (figura 3). Deri në shtator 2019, inflacioni bazë rezultoi të jetë 0.4 përqind, apo 2.6 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamikat e shportës së konsumatorit kosovarë përcaktohen kryesisht nga lëvizja e çmimeve

të importit, të cilat deri në qershor 2019 shënuan rritje mesatare prej 3.7 përqind që është nivel paksa më i lartë se sa indeksi i çmimeve të konsumit. Përveç çmimeve të importit me rritje prej 1.5 përqind janë karakterizuar edhe çmimet e prodhimit por që kjo normë e rritjes ishte dukshëm më e ulët krahasuar me çmimet e importit.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² deri në shtator 2019 arritën vlerën neto prej 1.38 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.9 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore³ arritën vlerën prej 1.34 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 përqind. Si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 39.1 milionë euro (0.8 milionë euro deficit në periudhën e njëjtë të vitit 2018).

Rritja më e lartë e të hyrave buxhetore u diktua kryesisht nga ecuria e zërave të lidhur me importin e mallrave. Të hyrat tatimore indirekte përbëjnë rreth 75.0 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore dhe janë kryesisht të hyra tatimore që mblidhen në kufi. Këto të hyra arritën vlerën prej 1.03 miliardë euro apo 4.4 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Të hyrave tatimore direkte arritën vlerën prej 219.9 milionë euro apo 11.3 përqind rritje. Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 14.1 përqind dhe arritën vlerën prej 157.3 milionë euro.

Rritja më e ngadalësuar e shpenzimeve buxhetore erdhi si pasojë e vonësive në aprovimin e Buxhetit për

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

vitin 2019 nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kategoria kryesore që kontribuoj në rritjen e ngadalësuar të shpenzimeve buxhetore ishte ajo e shpenzimeve kapitale të cilat ishin për 12.7 përqind më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan rritje. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje prej 4.1 përqind dhe arritën vlerën prej 457.3 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 16.0 përqind dhe arritën vlerën prej 183.4 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 11.0 përqind dhe arritën vlerën prej 445.6 milionë euro.

Borxhi publik në TM3 2019 ka arritur në 1.19 miliardë euro që është për 10.7 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.4 përqind nga 16.9 përqind sa ishte në TM3 2018. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 18.6 përqind (i cili ka arritur në 786.9 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka rënë në 408.5 milionë euro që është për 1.9 përqind më i ulët krahasuar me TM3 2018. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është zvogëluar në 34.2 përqind nga 38.6 përqind sa ishte në shtator 2018. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj dhe po ashtu e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit.

Sektori Financiar⁴

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019, asetet e sistemit financiar vazhduan trendin e rritjes duke shënuar rritje vjetore prej 12.5 përqind dhe duke arritur vlerën prej 7.0 miliardë euro në fund të periudhës raportuese. Kontributin kryesor të zgjerimit të aktivitetit të sistemit financiar vazhdon ta ketë sektori bankar, pasur nga sektori pensional. Rritja e asetëve të sektorit bankar u mundësua kryesisht nga rritja e aktivitetit kreditues, që erdhi si rezultat i kërkesës së rritur për kredi dhe përmirësimit të kushteve të kreditimit. Gjatë TM3 2019, vlera e kredive të lëshuara shënoi rritje, mirëpo krahas tremujorit të tretë të vitit paraparak, kjo vlerë ishte më e ulët, e ndikuar kryesisht nga rënia e kredive për korporatat jofinanciare.

Zgjerimi i aktivitetit kreditues u mundësua nga zhvillimet pozitive të depozitave, të cilat vetëm gjatë TM3 2019 u rritën për 310.3 milionë euro. Rritje më të theksuar kishin depozitat e ekonomive familjare, pjesa më e madhe e të cilave përbëhet nga depozitat e transferueshme. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare shënoi rënie për 0.2 pikë përqindje krahas periudhës së njëjtë të vitit paraparak, ndërsa norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rritje të lehtë për 0.04 pikë përqindje.

Sektori bankar edhe gjatë TM3 2019 vazhdoi të ketë performancë të mirë, si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave krahas shpenzimeve. Rritja e të hyrave në baza tremujore ishte 11.5 përqind, e mundësuar kryesisht nga rritja e të hyrave nga interesi. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rritje më të ngadalësuar, prej 4.7 përqind. Sa i përket shëndetit financiar,

⁴ Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM3 2019) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

sektori bankar vazhdoi të ketë nivel të ulët të kredive joperformuese prej 2.3 përqind dhe rritje të mbulueshmërisë së tyre me provizione prej 161.2 përqind. Për më shumë, indikatorët përkatës sugjerojnë që niveli i kapitalizimit dhe likuiditetit të sektorit është në nivel të kënaqshëm.

Sektori pensional si sektori i dytë për nga pesha e rëndësisë në sistemin financiar, edhe gjatë këtij tremujori vazhdoi të ketë kthim pozitiv në investime dhe rritje të kontributeve të reja. Këto zhvillime mundësuan rritjen e aseteve në përgjithësi. Sektori i sigurimeve në baza tremujore shënoi përmirësim të aktivitetit bazuar në trendin e rritjes së primeve të shkruara dhe dëmeve të paguara. Përkundër rezultateve negative financiare në fund të periudhës, vetëm gjatë TM3 2019, fitimi neto shënoi rritje. Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të aktivitetit, si për nga ana e aktivitetit kreditues, ashtu edhe nga performanca e realizuar.


Gjatë TM3 2019, në tregun e letrave me vlerë, shuma e borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës ishte 105 milionë euro dhe norma mesatare e interesit në letrat me vlerë ishte 2.11 përqind.

Sektori i Jashtëm

Deri në gusht 2019, deficitin e llogarisë rrjedhëse ishte 67.0 milionë euro që është për 60.7 përqind më i ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ndërsa

deficitin e mallrave ka shënuar rritje të ngadalësuar (figura 4).

Figura 4. Deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro




Deficitin e llogarisë e mallrave⁵ arriti vlerën prej 1.26 miliardë euro deri në shtator 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 3.3 përqind. Përderisa në vitin 2018 ishte shënuar rënie e eksportit të mallrave dhe përshpejtim i rritjes së importit, në vitin 2019 është duke u shënuar rritje e eksportit të mallrave dhe rritje më e ngadalësuar e importit. Kjo ka ndikuar që shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte të ketë një përmirësim nga 10.8 përqind sa ishte në shtator 2018 në 11.3 përqind në shtator 2019.

Eksportit të mallrave deri në shtator 2019 ka shënuar vlerën prej 288.8 milionë euro, që është për 9.0 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 (figura 5).

⁵ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.


Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2019)

Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë, produktet e plastikës dhe gomës si dhe makineritë dhe pajisjet elektrike. Në anën tjetër, rënie shënoj eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, eksporti i perimeve, etj. (figura 6).


Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2019)

Vlera e importit të mallrave deri në shtator 2019 ishte 2.5 miliardë euro, që është për 3.6 përqind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Rritje më e lartë u shënuar tek importi i mjeteve të transportit, produkteve minerale, tekstilit dhe artikujve të tekstilit si dhe produktet e plastikës dhe gomës, etj. (figura 7).

Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2019)

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoj vlerën prej 803.3 milionë euro deri në gusht 2019, një rritje prej 11.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoj rritje vjetore prej 8.5 përqind, duke arritur në 1.3 miliardë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoj rritje prej 4.3 përqind dhe arriti në 499.1 milionë euro.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore, deri në gusht 2019, shënoj vlerën prej 115.5 milionë euro, që paraqet një rritje prej 73.0 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoj rritje për 2.2 përqind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan vlerën prej 553.3 milionë euro deri në gusht 2019, apo 6.3 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018 (figura 8).

Figura 8. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2019)

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, prej nga dërgohen 41.3 përkatësisht 19.8 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.1 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Në kuadër të llogarisë financiare, hyrjet e IHD-ve në Kosovë arritën vlerën prej 199.2 milionë euro duke shënuar rritje prej 22.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 161.0 milionë euro dhe shënoj rritje prej 2.1 përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 38.2 milionë euro (4.4 milionë euro në periudhën e njëjtët të vitit 2018) (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Niveli më i lartë i IHD-ve u shënuar në sektorin e patundshmërisë (150.8 milionë euro) dhe krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018 kishte rënie për 1.1 përqind. Sektori i dytë për nga rëndësia ishte ai i shërbimeve financiare ku niveli i IHD-ve ishte 24.3 milionë euro (-10.5 milionë euro në periudhën e njëjtët të vitit 2018). Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD (53.4 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 41.2 milionë euro, SHBA-të me 27.9 milionë euro, etj.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2019): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 28, TM3 2019, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2019):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2019):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-prill-2019>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-icp-tm4-2018>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-importit-icimp-tm4-2018>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/repertori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm4-2018>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-mars-2019>

IMF (2019): World Economic Outlook:

<https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2019/01/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2018	Shtator 2019
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	3,066.6	3,245.3
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.7%	3.0%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.5%	2.4%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,289.9	1,379.3
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,290.7	1,340.3
Bilanci primar (në milionë euro)	-0.8	39.1
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	6,226.2	7,006.3
prej të cilave: Bankat	4,033.3	4,577.2
Kredi	2,681.1	2,957.2
Depozita	3,210.1	3,735.6
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	7.0%	6.5%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.4%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	5.6%	5.0%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-180.8	-76.5
prej të cilave: remitencat e pranuar	520.3	553.3
Llogaria financiare	-120.5	-0.5
Investimet e huaj direkte në Kosovë	162.1	199.2
Investimet portfolio, net	-31.6	-59.5
Investimet tjera, net	-192.2	-123.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-257.1	-452.4
Asetet	4,755.3	4,912.3
Detyrimet	5,012.4	5,364.7
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,072.2	2,141.7
Borxhi i jashtëm privat	1,575.6	1,649.9
Borxhi i jashtëm publik	496.7	491.7

Burimi:

1/ ASK (2019), BPV është vetëm për TM1 sepse për TM2 2019 nuk është publikuar ende.

2/ MF (2019).

3/ BQK (2019).

*Të dhënat për bilancin e pagesave janë deri në gusht 2019 ndërsa për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm deri në qershor 2019.

